



Membre de UNIVERSITÉ CÔTE D'AZUR 

## **Konferencë Shkencore Ndërkombëtare**

Fakulteti Shkencave Politike Juridike

Departamenti Administrim Publik

27 MARS 2019

**Departamenti Administrim Publik në bashkëpunim me Universitetin Sophia Antipolis organizon:**

**Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë**

**“Sfidat e organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore në Shqipëri në kuadër të reformës administrative”**

Data 27 Mars 2019

Kampus 2, Spitalë, Durrës

**Thirrje për pjesëmarrje**

Departamenti Administrim Publik, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Universiteti “Aleksandër Moisiu, Durrës, në bashkëpunim me Universitetin Sofia Antipolis, Nicë, Francë organizojnë Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Sfidat e organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore në Shqipëri në kuadër të reformës administrative”, e cila do të mbahet më 27.03.2019 në Durrës.

Qëllimi kryesor i kësaj konference është të stimulojë debatin ndërmjet akademikëve, ekspertëve, përfaqësuesve të qeverisjes qëndrore, vendore si dhe grupeve të interesit etj. në mënyrë që të prezantojnë gjetjet e tyre më të rëndësishme për çështjet, problemet e sfidat me të cilat përballen organet e qeverisjes vendore pas implementimit të Reformës Administrative- Territoriale, qëllimi

I së cilës është përmirësimi i qeverisjes, aksesit plotë dhe cilësor i qytetarëve në shërbime publike, demokracia lokale dhe zhvillimi ekonomik lokal.

Niveli vendor është ai në të cilin ushtrohet demokracia e drejtpërdrejtë dhe përfaqësimi qytetar, ku ofrohen shërbimet dhe ku ndodh zhvillimi shoqëror dhe ekonomik. Qeveritë vendore luajnë një rol kritik në formësimin dhe zhvillimin e jetës shoqërore dhe ekonomike të territoreve të tyre, duke i sjellë komunitetet më pranë njëri-tjetrit dhe duke ofruar zgjidhje vendore për probleme vendore.

Kjo konferencë ka si synim të nxisë hulumtimet, kërkimin, diskutimin dhe të menduarit kritik rreth çështjeve të lidhura me sfidat e pushtetit vendor në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, administrimin e financave publike, zhvillimin lokal dhe administrimin e burimeve natyrore, harmonizimin e kuadrit ligjor qendror me atë lokal etj.

Kjo konferencë ka si qëllim që të krijojë një debat konstruktiv e të nxjerrë konkluzione e rekomandime në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe aftësisë së njësive vendore për të ofruar shërbime më të mira dhe për t'u dhënë qytetarëve dhe komuniteteve më shumë akses në këto shërbime.

Të gjithë pjesëmarrësit e interesuar mund të paraqesin një abstrakt të zgjeruar me 1000-1500 fjalë. Abstraktet do të shqyrtohen dhe pranohen mbi bazën e cilësisë së tyre dhe lidhjes me fushën e studimit të Konferencës. Të gjitha punimet e përzgjedhura për pjesëmarrje duhet të jenë origjinale dhe të mos jenë publikuar tjetërkund.

Konferenca do të jetë e përqendruar, por jo e kufizuar në tematikat e mëposhtme:

- Sfidat e decentralizimit të pushtetit lokal dhe politikave publike në kuadër të decentralizimit
- E ardhmja e financave publike lokale, menaxhimi financiar
- Përgjegjësia qytetare në administrimin e fondeve të pushtetit lokal
- Qeverisja financiare lokale
- Sfidat e medias lokale, kalimi nga periudha analoge në atë dixhitale
- Sa dhe si respektohet autonomia e pushtetit lokal
- Besimi qytetar tek pushteti lokal
- Zhvillimi lokal dhe administrimi i burimeve natyrore
- Administrimi i financave publike
- Sfidat e njësive të qeverisjes vendore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
- Sfidat e pushtetit lokal në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore
- Roli i pushtetit lokal në fushën e menaxhimit të burimeve ujore
- Raporti midis pushtetit politik, dimensionit social dhe qeverisja vendore, roli i politikës në menaxhimin e problemeve lokale
- E drejta publike e administratës lokale
- Financimi i aksioneve publike në bashkinë e Durrësit
- Treguesit sasiore dhe cilësore të matjes të të gjitha formave të decentralizimit të pushtetit lokal. Situata aktuale dhe sfida e së ardhmes.
- Harmonizimi dhe konflikti i kuadrit ligjor qendror me atë lokal.
- Strukturat e reja administrative dhe sfida e decentralizimit administrativ
- Sfidat e buxhetimit gjinor në hartën e re administrative - territoriale.
- Pjesëmarrja qytetare, garancia demokratike e qeverisjes lokale në hartën e re territoriale

- Financat publike dhe qeverisja, procesi i buxhetimit publik
- Drejtimi i turizmit dhe roli i qeverisjes vendore në këtë proces

#### DATA TË RËNDËSISHME

Dorëzimi i Abstrakteve të zgjeruara: 31.01.2019

Njoftimi i Pranimit: 15.02.2019

Afati i pagesës: 01.03.2019

Data e Konferencës: 27.03.2019

Propozimi me 1000-1500 fjalë duhet të dërgohet në adresën e emailit:  
**uamd.nice.conference@gmail.com**

#### ***Udhëzime për Abstraktin e zgjeruar:***

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

♣ Gjuhët zyrtare të Konferencës janë Shqip, Anglisht dhe Frengjisht.

♣ Abstraktet mund të shkruhen në gjuhën shqipe, angleze ose franceze.

Abstraktet e paraqitura në gjuhën shqipe duhet të dërgohen në shqip dhe anglisht ose në frengjisht sipas rastit.

♣ Abstrakti duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës, dhe me seksionin përkatës, shtyllat kryesore të shfletimit të literaturës, qasjen e përdorur, pikat kryesore të analizës, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre, konkluzionet më të rëndësishme, bibliografinë e plotë si dhe 4-5 fjalë kyçe.

♣ Emrin e plotë të autorit/autorëve, përkatësinë institucionale, panelin përkatës, dhe adresën e e-mail-it.

Udhëzimet për shkrimin e Punimit:

♣ Abstraktet duhet të paraqiten në formatin Microsoft Word.

♣ Format i shkrimit: 12-pt. Font Times New Roman dhe 10-pt. për referencat, shtojcat, shënimet në fund të faqes, tabelat dhe figurat.

Tarifa e Konferencës është 50 euro për punim. Pagesa duhet të kryhet jo më vonë se data 01.03.2019 në numrin e llogarisë që do të dërgohet me e-mail tek të gjithë autorët punimet e të cilëve janë pranuar.

Tarifa përfshin:

♣ Një kopje të Librit të Abstrakteve;

♣ Çertifikatën e Pjesëmarrjes;

♣ Kafet e pushimit

♣ Pushim Dreke

Format e prezantimit të punimeve:

♣ Prezantim Verbal

♣ Prezantim me Power Point

♣ Prezantim me Poster

Lutemi që pjesëmarrësit të përcaktojnë formën e prezantimit të dëshiruar në propozimin e tyre të punimit.

Do t'iu ishëm mirënjohës nëse ju e ndani këtë Thirrje për Pjesëmarrje të Konferencës edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj. Ju falenderojmë për interesimin tuaj dhe shpresojmë të shihemi në pranverë në qytetin e bukur të Durrësit!

Për çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni:

Abla Tepelena

[uamd.nice.conference@gmail.com](mailto:uamd.nice.conference@gmail.com)

[ablatepelena@yahoo.com](mailto:ablatepelena@yahoo.com)

+355 69 22 06 608



## **INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE**

Faculty of the Political Sciences and Law

Department of Public Administration

27<sup>th</sup> MARCH 2019

**The Department of Public Administration in cooperation with Sophia Antipolis University organize:**

**The International Scientific Conference**

**“Challenges of organization and functioning of local government in Albania in the framework of the Administrative reform”**

Date 27<sup>th</sup> March 2019

Campus 2, Spitallë, Durrës

**Call for participation**

The Department of Public Administration at the Faculty of the Political Sciences and Law, “Aleksandër Moisiu”, University of Durrës, in cooperation with Sophia Antipolis University, Nice, France organize the International Scientific Conference “Challenges of organization and functioning of local government in Albania in the framework of the Administrative Reform”, which will be held on 27<sup>th</sup> March 2019 in Durrës, Albania.

The main aim of the conference is to stimulate debate amongst academics, experts, representatives of central and local governments and interest groups in order to present their most important findings on issues, problems, and challenges faced by the local government bodies after the implementation of the Administrative-Territorial Reform, the aim of which is to

improve governance, full and qualitative access of citizens to public services, local democracy and local economic development. The local level is the one in which direct democracy and civic representation are exercised, where services are provided and where social and economic development takes place. Local governments play a critical role in shaping and developing the social and economic life of their territories, bringing communities closer to each other and providing local solutions to local problems.

The vision of this conference is to promote research, discussion and critical thinking about issues related to the challenges of the local government in the fight against corruption and organized crime, public finance management, local development and management of natural resources, harmonization of the national legal framework with the local one, etc.

This conference aims to create a constructive debate and to draw conclusions and recommendations in the framework of increasing the efficiency and ability of local units to provide better services and give citizens and communities more access to these services.

All interested participants can submit an abstract of 1000-1500 words. Extended abstracts will be reviewed and accepted on the basis of their quality and relevance to the research area of the Conference. All selected abstracts must be original and must have not been published elsewhere.

The conference will be focused, but not limited to the following topics:

- Challenges of decentralization of the local government and public policies in the context of decentralization
- The future of local public finances, financial management
- Citizens responsibility in the administration of the local government funds
- Local financial governance
- The challenges of the local media, the period of transition from the analogue to the digital one.
- How much and how is the autonomy of the local government respected
- Citizen's trust in the local government
- Local development and management of natural resources
- Public finance management
- Challenges of local government units in the fight against corruption and organized crime
- Challenges of local government in addressing gender equality issues
- The role of the local government in water resource management
- The relationship between political power, social dimension and local government, the role of politics in managing local problems
- Public law of the local administration
- The financing of public actions in the municipality of Durres
- Quantitative and qualitative indicators of the measurement of all forms of decentralization of local government. Current Situation and Future Challenges
- Harmonization and conflict of the central legal framework with the local one
- New administrative structures and the challenge of administrative decentralization
- Challenges of gender budgeting in the new administrative-territorial map
- Citizen Participation, the democratic guarantee of local governance in the new territorial map

- Public Finances and Governance, the Public Budgeting Process
- Tourism management and the role of local government in this process

**IMPORTANT DATES:**

Submitting Extended Abstracts: 31.01.2019

Acceptance Notice: 15.02.2019

Payment deadline: 01.03.2019

Conference date: 27.03.2019

The 1000-1500 words proposal should be sent to: **uamd.nice.conference@gmail.com**

**Guidelines for extended Abstract:**

Abstracts submitted should be written in accordance with the following guidelines:

- The official languages of the Conference are Albanian, English and French.
  - Abstracts should be written in Albanian, English or French.
- The abstract of the works presented in Albanian should be sent both in Albanian and English or French.
- The abstract should clearly indicate the purpose of the research and its connection to the topic of the Conference and the relevant section, the main pillars of literature browsing, the approach used, the main topics of analysis, the main research results and their relevance, the most important conclusions, full bibliography as well as 4-5 keywords.
  - The full name of the author / authors, the institutional affiliation, the respective panel, and the e-mail address

**Guidelines for Writing a Paper:**

- Format: Abstracts should be presented in Microsoft Word format.
- Font Size and Type: 12-pt. Font Times New Roman and 10-pt. for references, appendixes, footnotes, tables, and figures.

The Conference fee is 50 Euro for every extended abstract. Payment must be done **no later than March 1<sup>st</sup>, 2019** at the account number that will be sent by e-mail to all authors whose papers have been accepted.

The fee includes:

- One copy of the Proceedings Book
- Certificate of Participation.
- Coffe breaks
- Lunch break

Presentation Form:

- Oral Presentation
- Power Point presentation

- Poster Presentation

Participants are required to indicate the desired presentation form at their paper proposals.

We would appreciate if you share this Call for Paper with your colleagues and collaborators.  
Thank you very much for your interest and hope to see you in spring in the beautiful city of Durrës!

For any queries related to the conference, please do not hesitate to write to:

Abla Tepelena

[uamd.nice.conference@gmail.com](mailto:uamd.nice.conference@gmail.com)

[ablatepelena@yahoo.com](mailto:ablatepelena@yahoo.com)

+355 69 22 06 608